



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 88 , Datë 29 / 8 / 2017

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 77 Regj, datë 02.08.2017, e N. M¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²

K O N S T A T O I:

Znj.M informon Komisionerin se aktualisht ajo është e papunë. Ajo citon se: “ *Jam e ve, me 4(katër) fëmijë në kujdestari dhe në vështirësi financiare për t’u kujdesur për familjen time. Kam kërkuar punë pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Berat por nuk kam marrë asnjë përgjigje pozitive*”.

Raca është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi për shkak të racës përbën shkak të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, i cili parashikon se: “...“*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së

¹ Ankesa është marrë në kuadër të “Ditëve të hapura”, me komunitetin rom të Lagjes “Stan-Moravë” / Berat, organizuar nga KMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me anë të shkresës me Nr.780/1 Prot., datë 10.08.2017, Komisioneri ka kërkuar informacione nga ana e Zyrës Rajonale të Punësimit Berat, lidhur me ankesën bërë nga znj. M.

Me shkresën me Nr.395/1 Prot., datë 15.08.2017, nga ana e Zyrës Rajonale të Punësimit Berat sqarohet se “... sipas verifikimit të kryer prej tyre, znj. M nuk është paraqitur asnjëherë pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Berat për të aplikuar për punë”.

Duke u bazuar në analizimin e rastit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga palët, **konkludojmë se:**

Bazuar në përgjigjen shkresore sa më sipër, nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e Zyrës Rajonale të Punësimit Berat, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk është paraqitur fare pranë kësaj Zyre për të aplikuar apo kërkuar punë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gjerat a) dhe c), nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminit për shkak të racës, të N. M, nga ana e Zyrës Rajonale të Punësimit Berat.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, të paraqitet pranë Zyrës Rajonale të Punësimit Berat, për të aplikuar për punë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Shërbime
Shkaku: Raca
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim